

Akt Themelimi

I shoqërisë tregtare “**CENTRO AFFARI**” SH.P.K.

Mbeshtetur në Kushtetuten dhe Kodin Civil në Fuqi të Republikës së Shqipërisë, në ligjin Nr.7512 datë 10.08.1991 “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, nismës së lire dhe të veprimtarisë private dhe privatizimit”, të ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008, “Për shoqëritë tregtare” dhe të ligjit Nr.9723, datë 03.05.2007 “Për Q.K.R dhe formalitetet që duhen respektuar nga Shoqëritë Tregtare, me vullnetin e tyre të lire, të shprehur edhe në nënshkrimin e këtij akt-themelimi, unë ortaku z. Eugenio Tosini, me nr. pasaporte AY8317210 krijoj shoqërinë tregtare me përgjegjësi të kufizuar “**CENTRO AFFARI**” SH.P.K. me akt themelimi si vijon :

Formulimi

Neni 1

Sot me datë 30.03.2021, formohet shoqëria tregtare private e quajtur “**CENTRO AFFARI**” SH.P.K. Shoqëria do të nënshtrohet legjislacionit Shqiptar, ndërsa deget që mund të krijohen do të nënshtrohen legjislacionit ku do të ketë seline dega. Shoqëria do të ushtroje veprimtarinë e saj në baze të këtij akti themelues dhe statutit të shoqërisë që do të miratohet nga ortaku themelues.

Selia e Shoqërisë

Neni 2

Selia e shoqërisë ndodhet në adresën: Në Kavajë, Lagja nr.2, Bulevardi Josif Budo, e ndodhur në zonë kadastrale nr.8551, pasuria me numer 4/368-N16

Shoqëria mund të ndryshojë seline e saj, të hapë zyra përfaqësie, dege, të krijojë filiale si brenda ashtu dhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendim të asamblesë dhe ortakeve të saj.

Objektivi i Veprimtarisë

Neni 3

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:

Projektim inxhinierik, prodhimin, instalimin dhe mirëmbajtjen e makinerive dhe pajisjeve industriale; import dhe eksport të makinave të prodhuara dhe pajisjeve të pjesëve të këmbimit; blerjen e të gjitha llojeve të mallrave, me qëllim për të shitur ato në formën e tyre origjinale ose të transformuara, importin dhe eksportin e tyre, si dhe riekportin e tyre pas përfundimit të procesit të prodhimit. Aktivitet në fushën e turizmit, shëndetësisë, hoteleri-restorante, agjensi shërbimesh për të gjitha llojet, përfaqësi tregtare, prodhimin dhe tregtimin e çdo lloji produkti bujqësor e blegtoral, agjensi mobilare dhe imobilare, si dhe çdo lloj aktiviteti prodhues dhe tregtar që lejohet nga ligji.

Kohezgjatja e Shoqërisë


Neni 4

Kohezgjatja e shoqërisë do të jetë me një afat të pacaktuar. Ajo mund shpërbehet në çdo kohë dhe për çfarëdo lloji shkak.

Kapitali i Shoqërisë

Neni 5

Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 100.000 lekë (njëqind mijë) Lekë.


TOSINI EUGENIO

1. Ortaku themelues z. Eugenio Tosini: Zoterues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 100.000 (njëqind mijë leke) që përben 100 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Drejtimi i Shoqërisë

Neni 6

Shoqëria do të drejtohet nga administratori i saj z. Eugenio Tosini i cili do të jetë dhe përfaqësuesi ligjor i saj. Ai është përfaqësuesi i Shoqërisë në marrëdhënie me të tretet dhe ka kompetenca të plota në drejtimin e saj. Cdo kontratë do të kryhet prej tij dhe në rast mungese nga një përfaqësues i pajisur me prokurë të posaçme.

Neni 7

Te ardhurat neto të shoqërisë i takojnë ortakut.

Neni 8

Ortaku ka të drejtë të emerojë dhe administratorë të tjerë të vlerave materiale. Ka të drejtë të caktojë financiare, likuidator për problemin e shoqërisë si dhe të pajtojë persona të tjerë si ortakë.

Neni 9

Konfliktet që mund të lindin do të zgjidhen në zbatim të legjislacionit Shqiptar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë.

Neni 10

Shoqëria ka vulën e saj me madhësi të zakonshme, me tekstin rreth saj.

Neni 11

Shoqëria deklarohet e krijuar në zbatim të plotë të normave të statutit dhe në përputhje me legjislacionin Shqiptar në fuqi dhe vecanerisht të Ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 "Për Krijimin e Shoqërive Tregtare", si dhe duke zbatuar ligjet ndërkombëtare dhe të vendit si dhe rregullave që zbatohen për biznesin që kryen kjo shoqëri .

Neni 12

Akti i themelimit u perpilua në 2 kopje, për t'ju shpërndarë organeve kompetente dhe një kopje do të mbetet në dokumentacionin bazë të shoqërisë "**CENTRO AFFARI**" SH.P.K.

Akti i themelimit nënshkruhet rregullisht nga ortakut.

Ortaku themelues:

Eugenio Tosini

TOSINI EUGENIO